

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me zyrtaren ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale kundër të pandehurit S. A. nga O., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 7 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.7497/13, të datës 11.09.2014 pas mbajtjes së shqyrtimit Gjyqësor-Publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Rukije Sheshivari, të akuzuarit, e me datë: 09.06.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari;**

**S. A.** nga babai K. dhe nëna H., e gjinisë I., i lindur më dt. *data e lindjes...* në O., ku edhe jeton, (K. .. – D.), me numër personal *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, i martuar, baba i 6 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kinse i pa dënuar më parë dhe nuk udhëhiqet ndonjë procedurë tjetër penale ndaj tij.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, me dt.25.10.2013, rreth orës 12:30, në rrugën “...” në O., saktësisht në afërsi të pompës së derivateve “...”, i pandehuri S. A., derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tipit “ VW Golf 2 “, me ngjyrë të zezë, me targa *numri i targave...*, nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik dhe ka rrezikuar jetën e njeriut, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 54 të ligjit për siguri në komunikacion rrugor, nuk ia ka përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, si dhe nuk i ka kushtuar kujdese të duhur pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, ashtu që me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet këmbësorin E. K. e cila ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë shikuar në perspektivën e drejtimit të automjetit, me ç ‘rast të dëmtuarës E. K. i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet,-

**-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 7 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata konform nenit, 4, 7,17, 23,41,43, 46 , 73 të KPRK-së si dhe nenit 365 dhe 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit ia shqipton :

**DËNIMIN ME GJOBË**

në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Dënimin e shqiptuar i pandehuri mund ta paguajë deri në 4 (katër) këste mujore në afat kohor prej 4 muajve e deri me datën 5 te muajit vijues, nga dita e marrjes se formës së prerë e këtij aktgjykimi

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **në kohëzgjatje prej 20 ditësh duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet;** i akuzuari që të në emër të shpenzimeve të procedurës penale gjykatës t'ia kompensoj shumën prej **40.88 euro** për ekspertizën e komunikacionit, **20 euro** për ekspertizë mjeko-ligjore si dhe në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

**I dëmtuari:** A. K. përfaqësueses ligjor (Prindi) i te dëmtuarës E. K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.7497/13, të datës 11.09.2014 Kundër S. A.t nga O., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378, par. 7, lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin Gjyqësor me dt:06.06.2017 dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin Gjyqësor, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit, PP.II.nr.7497/13, të datës 11.09.2014.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për natyrën, pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë.

Me qene se i akuzuari u deklarua duke bere pranimin e fajësisë për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 te KPRK-se nga gjykata kërkojmë qe i njëjti te shpallet fajtor dhe te gjykohet sipas ligjit, dhe me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin, respektivisht matjen e tije te merren parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë pranimi i fajësisë te deklaruar nga i njëjti si dhe rrethanës se vepra e shkaktuar penale është kryer ne rrethanat e pakujdesisë, gjykata te gjeje edhe rrethana te tjera lehtësuese bazuar nga neni 73 te KPRK-se.

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se: se shprehe keqardhje për atë qe ka ndodhur, unë jam ndier shume keq ne momentin e aksidentit dhe pasi qe kame dhënë deklaratën ne polici me kane sjell mjekun dhe me kane dhënë injeksion kundër tensionit pasi qe unë jam ndier shume keq për këtë aksident. Unë jam i punësuar por jam i vetmi mbajtës i familjes me një rroge te vogël dhe kame dy fëmijë student dhe një ne shkollë te mesme. Me familjen e te dëmtuarës sipas traditave jemi pajtuar dhe unë kam shprehur interesim pas aksidentit për shëndetin e vajzës, kundërshtimin e kam bere vetëm sa i përket lartësisë se dënimin. I premtoj gjykatës se do te jem shume me i kujdesshëm ne komunikacion dhe i propozoj gjykatës qe me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin te me caktoj një dënim sa me te lehte te mundshëm.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se ai me datë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë ekspertiza e komunikacionit e dt:06.02.2014,dhe ekspertiza mjeko-ligjore e dt:03.04.2014, si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.7

lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet i pandehuri. Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është e përgjegjshme dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ka shpreh keqardhje për të dëmtuarën, dhe se i ka premtuar gjykatës së më nuk do të përsërisë vepra penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti rrezikshmerin e veprës penale, dhe duke u nisur nga të gjitha këto gjykata i shqiptoi dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73.par.2, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit të veprës penale, si dhe do të ndikoj te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, palët e dëmtuar janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Mbi bazën e të thënave si më lart, në bazë të neneve 248 par.5 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Penal**  
**P.nr.2019/14, të dt:09.06.2017**

**Zyrtare Ligjore,**  
Dafina Ymeri

**Gjyqtari,**  
Kujtim Krasniqi

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë